VENDIM
Nr. 25, datë 11.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.5.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (L) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Luftim Mezini, Marcela Kërëku (Mezini)

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronave, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 21, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm i lidhur me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural, cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit, si dhe cenimin e mjetit efektiv të ankimit.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda 6 muajve.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 399/1–399/9 dhe 399/11 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*; nenet 1, 14 dhe vijues të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*; nenet 27, 50 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave *(ATP)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të R.M., i cili ka pasur në pronësi të tij një pronë në qytetin e Vlorës, të shtetëzuar gjatë periudhës 1945–1990.

2. Pas vitit 1990, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", kërkuesit i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(KKKP)*, Vlorë për njohjen dhe kompensimin e kësaj prone. Me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996, KKKP-ja, Vlorë ka vendosur: *"Të njohë si ish-pronar të kësaj prone z. R.M. (trashëgimtarët e tij) të një sipërfaqeje trualli prej 2570 m² të ndodhur në lagjen "4 Heronjtë", Vlorë, me kufi: Veri-A.M., Jug-D.A., Lindje-Z. e A.M, Perëndim-me rrugën "4 Heronjtë". Ish pronari posedon sipërfaqen e truallit prej 1076 m². Të kompensojë sipërfaqen e truallit prej 1494 m² në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, sipas disponibilitetit që do të ketë komisioni."*.

3. Në kushtet kur arkiva e KKKP-së, Vlorë është djegur gjatë trazirave të vitit 1995, trashëgimtarët ligjorë të R.M. e kanë krijuar dosjen nga e para me dokumentet origjinale që dispononin. Një kopje e saj është dorëzuar në vitin 2008 në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP)* nga F.M., trashëgimtar i R.M. Me vendimin nr. 249, datë 3.3.2009, AKKP-ja ka vendosur mosmiratimin e kërkesës së trashëgimtarëve të R.M. për kompensimin në të holla nga fondi i vitit 2008, si rrjedhojë e pamjaftueshmërisë së këtij fondi.

4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" *(ligji nr. 133/2015)*, AKKP-ja është transformuar në ATP *(neni 32 i ligjit)*.

5. Në vitet 2016, 2017 dhe 2018, përmes njoftimeve në media dhe njoftimeve zyrtare, ATP-ja ka publikuar emrin e subjektit të shpronësuar R.M., por jo vlerësimin financiar për pronën e tij. Për këtë arsye, kërkuesit i janë drejtuar me kërkesë ATP-së për vlerësimin financiar të pronës së tyre, si trashëgimtarë të R.M. Me shkresën nr. 770/1 prot., datë 11.2.2019, ATP-ja ka njoftuar kërkuesit se vendimi nr. 106, datë 19.6.1996 i KKKP-së, Vlorë, i depozituar në dosje, është në cilësinë e kopjes së njësuar, për rrjedhojë ajo është në pamundësi objektive për vlerësimin e këtij vendimi. Po kështu, ajo i ka orientuar ata t'i drejtohen rrugës gjyqësore për vërtetimin e faktit, marrëdhënies juridike mes tyre dhe shtetit.

6. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi kundër ATP-së, me objekt: *"1. Vlerësimin financiar të sipërfaqes së pronës prej 1494 m², sipas përcaktimeve të vendimit nr. 106, datë 19.6.1996, të K.K.K.Pronave ku është njohur si ish-pronar z. R.M. (trashëgimtarët e tij) për sipërfaqen e truallit prej 2570 m² të ndodhur në lagjen "4 Heronjtë", Vlorë dhe e drejta e kompensimit financiar të sipërfaqes së truallit 1494 m² nga sipërfaqja totale prej 2570 m². 2. Detyrimin e ATP-së për shlyerjen e vlerës monetare të vlerësimit financiar në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit R.M. për sipërfaqen e truallit prej 2570 m² të ndodhur në lagjen "4 Heronjtë", Vlorë, nga e cila sipërfaqja e truallit prej 1494 m² është njohur për kompensim financiar."*.

7. Me vendimin nr. 2761, datë 25.7.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vlerësimin financiar të pronës të llojit "truall" me sipërfaqe 1494 m², të njohur për kompensim me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996, të KKKP-së, Vlorë, në vlerën 16,289,082 lekë.

8. Kundër vendimit të lartpërmendur kanë ushtruar ankim ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë, ndërsa kërkuesi Luftim Mezini ka paraqitur kundërankim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 27.9.2019 me nr. 14245 (31138-03476-86-2019) akti.

9. Në kushtet kur çështja nuk ishte shqyrtuar ende nga Gjykata Administrative e Apelit, në datën 4.5.2022, kërkuesja Marcela Kërëku (Mezini) i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Me vendimin nr. 21, datë 16.6.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses.

10. Në datën 18.10.2022, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë sipas objektit. Në datën 14.12.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesit****,* në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se u janë cenuar:

11.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

11.1.1 *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes së tyre nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 dhe afatit 1-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së. Çështja e vlerësimit dhe kompensimit të pronës vazhdon prej 25 vjetësh, ndërsa pritet shqyrtimi i saj në Gjykatën Administrative të Apelit që prej 3 vjetësh e gjysmë. Çështja nuk është komplekse dhe kërkuesit kanë marrë vazhdimisht masa për shqyrtimin e saj, duke iu drejtuar disa herë gjyqtares relatore në Gjykatën Administrative të Apelit me kërkesa për përshpejtimin e gjykimit. Nga ana tjetër, në veçanti kërkuesi Luftim Mezini, i cili është në moshë të thyer, nga mosshqyrtimi në kohë i çështjes rrezikon që të mos gëzojë dhe të përfitojë nga e drejta e pronës. Edhe Gjykata ka pranuar se efektet e reformës në drejtësi nuk duhet t'i kalojnë individit barrën e vonesave të shkaktuara. Duke rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e gjykimit, Gjykata e Lartë e ka zgjatur edhe më tej këtë proces.

11.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi nr. 21, datë 16.6.2022, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, formalist, i përdorur si model për rrëzimin e të gjitha kërkesave të depozituara në këtë gjykatë për përshpejtimin e gjykimit, si dhe nuk ka mbajtur në konsideratë efektet *erga omnes* të vendimmarrjes së Gjykatës në lidhje me tejzgjatjen e gjykimit.

11.2. *E drejta e pronës në aspektin procedural*, e ndërlidhur me kërkimin kryesor, atë të cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Ata disponojnë titull pronësie e janë mbartës të të drejtave që burojnë prej tij, përfshirë edhe përfitimin nga vlerësimi financiar i pronës, dhe kërkesa e tyre për vlerësimin financiar të pronës është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

11.3. *E drejta për mjete efektive ankimi*. Në përputhje me nenin 460 të KPC-së dhe vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" *(vendimi nr. 78/2019)*, kërkuesit i janë drejtuar disa herë gjyqtares relatore në Gjykatën Administrative të Apelit për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tyre, duke i vënë në dukje natyrën e çështjes, afatet kohore ligjore për shqyrtimin e saj, si dhe gjendjen shëndetësore e moshën e thyer të kërkuesit Luftim Mezini. Çështja vazhdon të mbetet pa shqyrtim në atë gjykatë që prej 3 vjetësh e gjysmë, ndërsa kërkesa e tyre për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit e ka kthyer kërkesën për përshpejtimin e gjykimit në një mjet ankimi joefektiv. Mjetet në dispozicion të kërkuesve vazhdojnë të mbeten joefektive edhe pas vendimmarrjeve të Gjykatës për çështje të ngjashme. Po kështu, duke pasur parasysh numrin e lartë të çështjeve për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe moshën e thyer të kërkuesit Luftim Mezini, çështja e themelit për pronën, në veçanti për këtë kërkues, rrezikon të mbetet e parealizuar.

12. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, ka prapësuar:

12.1. Pretendimet e kërkuesve për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* janë të pabazuara, pasi nuk identifikohen shkelje të kësaj të drejte kushtetuese.

12.1.1. Sipas nenit 399/2, pika 3, të KPC-së, në kohëzgjatjen e gjykimit nuk llogaritet koha kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim. Situata aktuale e Gjykatës Administrative të Apelit është *sui generis,* e cila nuk ka të bëjë me shkaqe subjektive ose keqorganizimi të veprimtarisë së saj, por me volumin e madh të çështjeve në raport me një numër të kufizuar burimesh njerëzore, rrjedhojë kjo e procesit të vetingut, si dhe e pandemisë COVID-19. Po kështu, çështja është e një natyre të tillë që nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuesve dhe nuk ka të bëjë me një interes të ngushtë e vetjak që do të kërkonte shqyrtimin e saj me përparësi. Për rrjedhojë, në rastin e kërkuesve nuk është cenuar *standardi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*.

12.1.2. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi pretendimet e kërkuesve për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave janë analizuar dhe vlerësuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vendimmarrja e të cilit është e drejtë, ezauruese, e mbështetur në KPC dhe në respektim të kufijve të objektit të kërkesës e dispozitave që rregullojnë këtë kërkim.

12.2. Pretendimet e kërkuesve për cenimin e *së drejtës së pronës* janë të pambështetura.

13. ***Subjekti i interesuar, ATP-ja***, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

14. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Për sa i përket legjitimimit *ratione personae* të kërkuesve, Gjykata vëren se krahas konstatimit të cenimit të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, objekt i ankimit kushtetues individual, është edhe procesi i përfunduar me vendimin nr. 21, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje nga Marcela Kërëku (Mezini). Ndonëse ky proces është iniciuar nga kjo shtetase, Gjykata vlerëson se efektet juridike të tij shtrihen edhe ndaj kërkuesit Luftim Mezini. Për rrjedhojë, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesit legjitimohen *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Kriteri për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesit, të cilët përpara se t'i drejtohen Gjykatës duhet të vërtetojnë se kanë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të

çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar" (*ligji nr. 38/2017*), Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individi duhet t'i shfrytëzojë ato përpara se t'i drejtohet asaj *(shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, duke qenë këto mjete të reja, si dhe duke pasur parasysh qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështje të kësaj natyre, Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim *(shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi të saj *(shih vendimet nr. 39, datë 9.12.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në rastin konkret, kërkuesit kanë pretenduar se i janë drejtuar disa herë Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit dhe, në kushtet e mungesës së një vendimmarrjeje nga ajo gjykatë për çështjen, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, Gjykata vëren se kërkuesi Luftim Mezini ka paraqitur kërkesa për përshpejtimin e gjykimit në apel, përkatësisht në datat 9.10.2019, 18.11.2021 dhe 17.10.2022, ndërsa kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e cenimit të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është paraqitur nga Marcela Kërëku (Mezini). Në kushtet kur, siç u tha edhe më lart, efektet juridike të procesit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë shtrihen ndaj të dy kërkuesve *(shih paragrafin 15 të vendimit)*, për sa kohë që bëhet fjalë për të njëjtën çështje gjyqësore, Gjykata vlerëson se ata i kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohen Gjykatës.

19. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi, jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, i cili mban datën 16.6.2022, u është komunikuar kërkuesve në datën 14.7.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 18.10.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

20. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, të së drejtës së pronës në aspektin procedural, si dhe të së drejtës për mjete efektive ankimi, janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e gjykimit, në lidhje me vlerësimin financiar të pronës së tyre dhe shlyerjen e vlerës monetare nga ATP-ja, gjykim i cili është duke u zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përfshihet në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të analizojë bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

21. Kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi çështja e tyre është ende në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, pavarësisht se kanë kaluar mbi 3 vjet e gjysmë nga data e regjistrimit të saj në atë gjykatë, në shkelje të nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së.

22. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se në rastin e kërkuesve standardi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është cenuar, pasi në kohëzgjatjen e gjykimit nuk llogaritet koha kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për gjykim.

23. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Edhe pse ka konstatuar ndërhyrje në të drejtën e pronës private përmes miratimit të ligjit nr. 133/2015, i cili parashikoi që të shpronësuarit të mos shpërblehen plotësisht, Gjykata ka identifikuar si interes publik zgjidhjen e çështjes së pronave me një kosto financiare dhe kohëzgjatje sa më të arsyeshme, si dhe vendosjen e paqes sociale midis kategorive të ndryshme sociale që prek kjo çështje, e cila ka mbetur e pazgjidhur prej 25 vjetësh *(shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa i përket së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se çështja e kërkuesve lidhet me shtetëzimin, pra marrjen padrejtësisht nga shteti të pronës së trashëgimlënësit R.M. gjatë periudhës 1945–1990. Në vitin 2008 kërkuesit i janë drejtuar AKKP-së me kërkesë për kompensimin në të holla të pronës së tyre, çka nuk është pranuar prej kësaj të fundit për shkak të pamjaftueshmërisë së fondit. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, ata kanë kërkuar vlerësimin financiar të pronës nga ATP-ja. Kjo e fundit ka njoftuar kërkuesit për pamundësinë objektive të vlerësimit të vendimit nr. 106, datë 19.6.1996, të KKKP-së, Vlorë për shkak të depozitimit të tij në cilësinë e kopjes së njësuar. Në datën 25.2.2019, kërkuesit kanë paraqitur kërkesëpadi në gjykatën administrative të shkallës së parë, gjykimi përpara së cilës rezulton të ketë zgjatur 5 muaj. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesve dhe vlerësimin financiar të pronës së tyre në vlerën 16,289,082 lekë. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur ankim nga ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 27.9.2019 dhe ndonëse kanë kaluar mbi 3 vjet e 7 muaj, për të nuk kanë ende një vendimmarrje.

25. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata vëren se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë *(neni 399/2, pika 1, shkronja "a")*, që zgjatet edhe me 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve *(neni 109, i ligjit nr. 38/2017)*.

26. Kërkuesit kanë pretenduar se në gjykimin e çështjes nuk janë respektuar afatet ligjore, duke u zgjatur në mënyrë të paarsyeshme. Duke konsideruar afatet ligjore në rastin konkret, Gjykata vlerëson se gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit i ka tejkaluar ato, ndaj çështja do të analizohet në vijim sipas kritereve të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese.

27. Konkretisht, në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuesin *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 34, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, për të vlerësuar kohëzgjatjen e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit në rastin konkret dhe nëse kërkuesve u

është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor në këtë aspekt, këto kritere do të analizohen në vijim.

i. Sjellja e kërkuesve

28. Në lidhje me këtë kriter, kërkuesit kanë pretenduar se nuk janë bërë pengesë për gjykimin, si dhe i kanë shfrytëzuar të gjitha të drejtat e tyre procedurale për përshpejtimin e çështjes.

29. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Gjykata vëren se kërkuesit kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale dhe vonesa në gjykimin e çështjes nuk rezulton të ketë ardhur për shkak të tyre. Kështu, në përputhje me nenin 460 të KPC-së kërkuesi Luftim Mezini i është drejtuar disa herë administrativisht Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, sipas vendimit nr. 78/2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor *(KLGJ)*, ndërsa në datën 4.5.2022 kërkuesja Marcela Kërëku (Mezini) i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Për rrjedhojë, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se sjellja e kërkuesve nuk është bërë shkak për vonesat në shqyrtimin e çështjes së tyre.

ii. Kompleksiteti i çështjes

31. Kërkuesit kanë pretenduar se çështja nuk paraqet kompleksitet si për sa i përket marrëdhënies juridike në konflikt, ashtu edhe subjekteve pjesëmarrëse, çka provohet edhe nga fakti se gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar brenda afatit të arsyeshëm.

32. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objekti, faktet e kundërshtuara, volumi dhe natyra e provave, lloji dhe ndërthurja e ligjeve të zbatueshme, si dhe numri i palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja është e natyrës administrative dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Ajo ka pasur për objekt një kërkim të vetëm, konkretisht atë të vlerësimit financiar të pronës nga ATP-ja dhe shlyerjes prej saj të vlerës monetare. Në aspekt të numrit të palëve në proces, i cili, gjithashtu, analizohet për të vlerësuar kompleksitetin e çështjes, Gjykata konstaton se, si palë në gjykimin në shkallë të parë kanë qenë, krahas kërkuesve, ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit. Procedurat përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezultojnë të kenë zgjatur 5 muaj, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje me ankim të ATP-së dhe Avokaturës së Shtetit ndaj vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë.

34. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat në gjykimin në shkallë të dytë prej 3 vjetësh, 7 muajsh e 14 ditësh.

iii. Sjellja e autoriteteve

35. Kërkuesit kanë pretenduar se shkak për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ligjor është bërë sjellja e autoriteteve, të cilat nuk kanë marrë masat e nevojshme për të shmangur tejzgjatjen e afateve të gjykimit dhe, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës, u kanë ngarkuar atyre barrën e vonesave të shkaktuara nga reforma në drejtësi.

36. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se situata aktuale e Gjykatës Administrative të Apelit është *sui generis*, e cila nuk ka të bëjë me shkaqe subjektive ose keqorganizimi

të veprimtarisë së saj, por me volumin e madh të çështjeve në raport me një numër të kufizuar burimesh njerëzore, rrjedhojë kjo e procesit të vetingut, si dhe e pandemisë COVID-19.

37. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

38. Në jurisprudencën e saj, në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës dhe zgjidhjen e saj. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Për qëllime të shqyrtimit kushtetues të çështjes, Gjykata vlerësoi të merrte informacion nga Gjykata Administrative e Apelit lidhur me ngarkesën e gjyqtares relatore, së cilës i është caktuar për shqyrtim çështja e kërkuesve. Sipas informacionit të paraqitur nga Gjykata Administrative e Apelit rezulton se, për shkak të reformës në drejtësi, çështja e kërkuesve është shortuar dhe rishortuar tek 3 gjyqtarë të ndryshëm. Relatorja e fundit, B.H., së cilës i ka kaluar çështja në datën 9.3.2023, ka aktualisht në ngarkim 3321 çështje dhe po gjykon çështje të periudhës janar 2017, ndërsa për çështjen konkrete nuk ka ende një datë planifikimi. Po sipas kësaj gjykate, kërkuesit kanë depozituar 3 kërkesa për përshpejtim, konkretisht në datat 9.10.2019, 18.11.2021 dhe 17.10.2022 dhe, për kërkesën e fundit, në datën 18.10.2022, është vendosur refuzimi i saj, ndërsa për sa i përket zbatimit të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së, në datën 5.5.2023, gjykata ka informuar se kërkuesit nuk i janë drejtuar relatores aktuale, B.H., të caktuar në datën 9.3.2023, me kërkesë tjetër për përshpejtimin e gjykimit.

40. Gjykata rithekson se efektet e reformës në drejtësi nuk përbëjnë argument kushtetues në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave dhe evidenton se situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, pavarësisht se KLGJ-ja ka marrë masa konkrete përmes përcaktimit të kalendarit të çështjeve në gjykatën e apelit *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2023; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

41. Edhe pse sistemi gjyqësor në tërësi po përballet me ngarkesë si rezultat i zbatimit të reformës në drejtësi, kjo problematikë e përgjithshme nuk mund të rëndojë ose justifikojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkuesve. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se gjykimi administrativ i ankimit të subjekteve të interesuara vazhdon prej më shumë se 3 vjetësh e 7 muajsh pa vendimmarrje në shkallë të dytë, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në ligjin nr. 49/2012 *(shih paragrafin 25 të vendimit)* dhe ndonëse kjo çështje lidhet me shpërblimin e të shpronësuarve padrejtësisht nga shteti.

42. Duke pasur parasysh faktin se dosja origjinale e pronësisë, e djegur gjatë trazirave të vitit 1995, është krijuar sërish nga kërkuesit, si dhe rëndësinë e përfundimit të procesit të kthimit dhe

kompensimit të pronave brenda afateve të arsyeshme *(shih paragrafët 3 dhe 23 të vendimit)*, Gjykata vlerëson se në rastin e kërkuesve sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti të atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke shkaktuar vonesa të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së tyre.

iv. Çfarë përbën rrezik për kërkuesit

43. Kërkuesi Luftim Mezini ka pretenduar se për shkak të moshës së tij të thyer, ekziston mundësia që ai të mos gëzojë dhe përfitojë nga e drejta e pronës, si për shkak të mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ashtu edhe për shkak të numrit shumë të lartë të çështjeve për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, çka nënkupton se në eventualitetin e ushtrimit të rekursit nga palët, shqyrtimi i themelit të çështjes së tij do të zgjatet edhe më shumë.

44. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se çështja është e një natyre të tillë që nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuesve dhe nuk ka të bëjë me një interes të ngushtë e vetjak që do të kërkonte shqyrtimin e saj me përparësi.

45. Kriteri *"interesi i kërkuesit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të"* përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Sipas jurisprudencës kushtetuese disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "vetjake e jetësore" ose kur ekziston mundësia që kërkuesi të ndërrojë jetë deri në përfundim të procedurave, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti.

46. Sipas Gjykatës, në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

47. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesve, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e pronës dhe vlerësimin financiar të saj për efekt kompensimi. Në këtë aspekt, Gjykata merr në konsideratë edhe faktin që çështja e trajtimit të pronave ish-pronarëve dhe e vlerësimit financiar të tyre është trajtuar jo vetëm prej saj *(shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*, por edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Beshiri kundër Shqipërisë, datë 17.3.2020*, ku është vënë në dukje problematika e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit të kompensimit të pronave ish-pronarëve. Gjykata evidenton se me ligjin nr. 133/2015 ligjvënësi ka përcaktuar afatin 10-vjeçar për mbylljen e procesit të kompensimit *(neni 16, pika 6, i ligjit)*. Ndërkohë, sikundër kërkuesi Luftim Mezini thekson, ai është në moshën 82-vjeçare dhe, në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se ai ka një interes më të lartë për përmbylljen e procesit gjyqësor të kompensimit të pronës së tij. Për rrjedhojë, çmohet se çështja është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesve, në veçanti i kërkuesit Luftim Mezini, rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore *(shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

48. Në përfundim, duke pasur parasysh ngarkesën e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të gjyqtares relatore në këtë gjykatë, si dhe rrethanat e çështjes konkrete si: kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë të konsiderueshme për interesin e kërkuesve dhe sjelljen e autoriteteve, Gjykata çmon se e drejta për proces të rregullt ligjor është cenuar si rrjedhojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe se përmes vendimmarrjes së saj, Gjykata e Lartë u ka kaluar kërkuesve barrën e reformës në drejtësi, për rrjedhojë kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 21, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar brenda 9 muajve çështjen gjyqësore nr. 14245 (31138-03476-86-2019) akti.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.5.2023.
Shpallur më 12.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini
Anëtarë kundër: Ilir Toska, Elsa Toska, Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që u përket kërkuesve Luftim Mezini dhe Marcela Kërëku (Mezini), me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 21, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, i lidhur me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural, cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit, si dhe cenimin e mjetit efektiv të ankimit. Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda 6 muajve*", ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësojmë se duhet të ishte vendosur rrëzimi i saj.

2. Në vendimin për çështjen shumica ka marrë në analizë dhe ka vlerësuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, konkretisht: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuesin *(shih paragrafin 27 të vendimit)*. Ajo ka vlerësuar se kërkuesit kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale, duke iu drejtuar disa herë Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, në përputhje me nenin 460 të KPC-së, si dhe Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave dhe se nuk janë bërë shkak për vonesa në shqyrtimin e çështjes *(shih paragrafin 30 të vendimit)*. Po kështu, çështja nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesën në gjykimin në shkallë të dytë prej 3 vjetësh, 7 muajsh e 14 ditësh. Për sa i përket kriterit të sjelljes së autoriteteve, shumica, bazuar edhe në jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës për çështje të kësaj natyre, ka vlerësuar se situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet, që mund të

çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, pavarësisht se KLGJ-ja ka marrë masa konkrete përmes përcaktimit të kalendarit të çështjeve në gjykatën e apelit. Po sipas saj, sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke u shkaktuar kërkuesve vonesë të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së tyre *(shih paragrafin 42 të vendimit)*.

3. Ndërkohë që bashkohemi me shumicën, në lidhje me gjetjet për sa u përket këtyre kritereve, qëndrimi ynë ndahet për sa i përket vlerësimit të kriterit se "çfarë përbën rrezik për kërkuesit", pra pasojave që u shkaktohen atyre nga tejzgjatja e procedurave gjyqësore. Kështu, në lidhje me këtë kriter, kërkuesi Luftim Mezini ka pretenduar se si rrjedhojë e moshës së tij të thyer, ekziston mundësia që ai të mos gëzojë dhe përfitojë nga e drejta e pronës, si për shkak të mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ashtu edhe për shkak të numrit shumë të lartë të çështjeve për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, çka nënkupton se në eventualitetin e ushtrimit të rekursit nga palët, shqyrtimi i themelit të çështjes së tij do të zgjatet edhe më shumë.

4. Në analizë të këtij kriteri, bazuar në parimin *minimis non curat praetor*, shumica ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesve, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e pronës dhe vlerësimin financiar të saj për efekt kompensimi. Në këtë aspekt, shumica ka marrë në konsideratë edhe faktin që çështja e trajtimit të pronave ish-pronarëve dhe e vlerësimit financiar të tyre është trajtuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen *Beshiri kundër Shqipërisë, datë 17.3.2020*, ku është theksuar si problem edhe kohëzgjatja e paarsyeshme për kompensimin e pronave ish-pronarëve. Po sipas saj, me ligjin nr. 133/2015, ligjvënësi ka përcaktuar afatin 10-vjeçar për mbylljen e procesit të kompensimit *(neni 16, pika 6, i ligjit)*. Ndërkohë, kërkuesi Luftim Mezini është në moshën 82-vjeçare dhe, në këtë kontekst, ka një interes më të lartë për përmbylljen e procesit gjyqësor të kompensimit të pronës së tij. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesve, e në veçanti i kërkuesit Luftim Mezini, rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore *(shih paragrafin 47 të vendimit)*. Për rrjedhojë, ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 21, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar brenda 9 muajve çështjen gjyqësore nr. 14245 (31138-03476-86-2019) akti.

5. Edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së rezulton se vlerësimi nëse në një çështje të caktuar ka shkelje të afatit të arsyeshëm karakterizohet nga realizmi. Afati i arsyeshëm i parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ-së duhet vlerësuar në çdo rast në varësi të rrethanave të çështjes. Vlerësimi i këtij afati duhet bërë duke pasur parasysh kritere të tilla, si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuesit dhe e autoriteteve përkatëse, si dhe çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimin e GJEDNJ-së Frydlender k. Francës [DHM], datë 27.6.2000, § 43)*. Për sa i përket shpejtësisë që duhet treguar nga autoritetet, GJEDNJ-ja ka bërë dallim mes çështjeve që kërkojnë "kujdes të veçantë" dhe atyre ndaj të cilave kërkohet "kujdes veçanërisht i posaçëm" *(shih vendimin e GJEDNJ-së Süßmann k. Gjermanisë, datë 16.9.1996, § 61)*. Vendosja e një balance të drejtë mes aspekteve të ndryshme të detyrimit themelor të parashikuar në nenin 6/1 "Procedura gjyqësore të shpejta" përbën vetëm një element të "parimit të përgjithshëm të administrimit të drejtësisë" *(shih vendimin e GJEDNJ-së Boddaert k. Belgjikës, datë 12.10.1992, § 39)*.

6. Në vështrim të sa më lart, vlerësojmë se kriteri përcaktues dhe i domosdoshëm, që duhet të merret në konsideratë nga Gjykata në këto çështje, është "interesi i lartë i kërkuesit, si dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të", pasi vetëm ky kriter mund të bëjë dallimin, në situatën konkrete të ngarkesës në sistemin gjyqësor, mes nevojës për të zgjidhur të gjitha çështjet sipas afateve të arsyeshme dhe në zbatim të nenit 399 e vijues të KPC-së, por po ashtu edhe mundësisë e kapaciteteve aktuale të gjyqësorit për të respektuar këtë standard, jo vetëm përmes shpejtësisë, por edhe cilësisë së vendimmarrjes.

7. Fillimisht theksojmë se edhe gjyqtarët në pakicë ndajnë të njëjtin qëndrim se çështjet me bazë konflikti pronësinë për kategorinë e ish-pronarëve kanë rëndësi, pasi e drejta e pronës përbën shqetësim serioz për këtë kategori subjektesh, por duke pasur parasysh situatën post reformë të krijuar, fakti i të qenit objekt gjykimi një konflikt prone, në vetvete nuk i jep prioritet kësaj kategorie nga gjykatat. Në drejtim të përcaktimit të balancës mes çështjeve prioritare dhe situatës së rënduar me mbingarkesë çështjesh gjyqësore, tashmë janë përcaktuar çështjet të cilat do të jenë prioritare dhe çështja e kërkuesve nuk përfshihet në këtë kategori, sipas kuadrit rregullator zbatues mbi të cilin po ushtron veprimtarinë gjyqësori i zakonshëm. Parimi i shpejtësisë së gjykimit dhe i prioritizimit, jo duke u nisur vetëm nga periudha kohore e paraqitjes së kërkesës, padisë, ankimit ose rekursit, mund të zbatohet për një numër të caktuar çështjesh dhe kalendari i tyre është caktuar nga KLGJ-ja, duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, por edhe situatën aktuale të mbingarkesës.

8. Kështu, bazuar në nenin 460, pika 4, të KPC-së, KLGJ-ja ka nxjerrë vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" *(vendimi nr. 78/2019)*, që ka përcaktuar disa kategori çështjesh, shqyrtimi i të cilave, për shkak të natyrës dhe kategorisë, duhet përshpejtuar nga gjykatat. Sipas këtij vendimi, për sa i përket natyrës, çështjet që kërkojnë përshpejtim janë: a) çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës ose që kanë ndikim te një fëmijë i mitur; b) çështjet që kanë për objekt zgjidhjen ose pavlefshmërinë e martesës; c) çështjet që kanë për objekt detyrimin për ushqim; ç) çështjet që kanë për objekt kujdestarinë; d) çështjet që kanë për objekt heqjen, kufizimin ose kthimin e zotësisë për të vepruar dhe ato që kanë për objekt të drejta të personave që iu është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar; dh) çështjet që kanë për objekt birësimin; e) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë është shprehur me vendim jopërfundimtar, ndaj të cilit është ushtruar e drejta e ankimit të veçantë, të tilla si: çështjet me objekt ndreqjen e gabimit, sqarimin ose interpretimin e vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet me objekt rivendosjen në afat të ankimit në gjykatën e apelit; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur kthimin e akteve ose pushimin e gjykimit; ë) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e dhënies/lëshimit të urdhrit të ekzekutimit; f) çështjet që kanë për objekt plotësim të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; g) çështjet që kanë për objekt vërtetimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë ose njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike për sa i përket përfitimit të pensionit; gj) çështjet që kanë për objekt shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e kontratës së punës; h) çështjet në të cilat pala që ka paraqitur ankim heq dorë nga ankimi ose ato në të cilat paditësi heq dorë nga e drejta e padisë, i) çështjet me interes ose ndjeshmëri veçanërisht të lartë për opinionin publik ose ato që prekin interesa të komuniteteve të caktuara, në veçanti ato në nevojë.

9. Përveç sa më lart, vendimi i KLGJ-së parashikon se për çdo lloj çështjeje, pavarësisht natyrës dhe kategorisë së saj, palët mund të kërkojnë përshpejtimin e shqyrtimit të saj për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin. Këto shkaqe vlerësohen nga gjyqtari relator sipas bindjes së tij të brendshme, bazuar në rrethanat e parashtruara nga pala. Me "shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara" nënkuptohen ato shkaqe personale të palës, të lidhura me shqyrtimin e çështjes dhe objektin e saj apo ato shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse, ekzistenca e të cilave motivon shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes, domethënë shqyrtimin e saj në një afat më të shkurtër nga afati ligjor ose nga afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të KPC-së dhe/ose sipas këtij neni, në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017. "Shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara" mund të jenë, pa u kufizuar: ... b) gjendja shëndetësore e palës ose mosha e saj është e

tillë që mund të vërë në dyshim pritshmërinë e saj për një vendim gjyqësor që lidhet me një të drejtë personale *(shih pikat 4, 5 dhe 6, kreu II, të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së)*.

10. Në rastin në shqyrtim, nga informacioni i paraqitur për çështjen nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. 875/1 prot., datë 5.5.2023 të saj, rezulton se pranë kësaj gjykate janë paraqitur disa kërkesa për përshpejtimin e çështjes, respektivisht në datat 9.10.2019, 18.11.2021 dhe 17.10.2022. Kërkesa e fundit është refuzuar nga gjyqtarja relatore A.N., e cila ka vlerësuar se, për nga natyra, çështja nuk ishte e tillë që kërkonte përshpejtimin.

11. Në këndvështrim të sa më sipër, duke vendosur pranimin e kërkesës, bazuar në të drejtën e pronës dhe moshën e kërkuesit Luftim Mezini, në vlerësimin tonë shumica ka vendosur kritere të reja, të paqarta, në drejtim të çështjeve që kërkojnë prioritet në shqyrtim nga gjykatat e apelit. Ajo nuk ka marrë parasysh faktin se çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 27.9.2019, ndërkohë që aktualisht gjyqtarja relatore në këtë gjykatë po shqyrton çështje të periudhës janar 2017. Për rrjedhojë, duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesve, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 9 muajve, nisur nga specifikat e rastit në shqyrtim dhe situata konkrete e gjyqësorit, mendojmë se qëndrimi i shumicës krijon një "padrejtësi të re" ndaj çështjeve të regjistruara në gjykatë para asaj të kërkuesve, subjektet kërkuese të të cilave mund të ndodhen në të njëjtat kushte si ato në çështjen konkrete ose edhe më të përligjura.

12. Për sa më lart, duke pranuar se ka shkelje të kohëzgjatjes së arsyeshme dhe duke vendosur detyrim për Gjykatën Administrative të Apelit që brenda 9 muajve të shqyrtojë themelin e çështjes, mendojmë se shumica nuk ka reflektuar qasjen e duhur as mbi efektivitetin e vendimeve të Gjykatës, të cilat rrezikojnë të mbeten të pazbatuara, as mbi pamundësinë apo mundësinë e asaj gjykate për të shqyrtuar këtë çështje. Në këtë drejtim, shumica nuk ka qartësuar se mbi cilat kritere e konsideron të mjaftueshëm afatin 9-mujor të caktuar në kuptimin që ai u përgjigjet kushteve e mundësive të Gjykatës Administrative të Apelit (relatores) për të vepruar në çështjen e kërkuesve. Nga ana tjetër, duke detyruar Gjykatën Administrative të Apelit për të marrë në shqyrtim çështjen e kërkuesve brenda 9 muajve, në vlerësimin tonë shumica ka vendosur një kriter iluzor në raport me 3321 çështje aktualisht në shqyrtim nga gjyqtarja relatore.

13. Për më tepër, vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së, për sa i përket kategorisë, ka parashikuar se kërkojnë, gjithashtu, përparësi në përshpejtim çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese *(shih pikën 3.2, të vendimit nr. 78/2019, të KLGJ-së)*, një arsye më tepër për të pasur kujdes në vënien e afateve që mund të krijojnë përplasje me kalendarin e çështjeve, ku mund të jenë në shqyrtim çështje më prioritare.

14. Në vështrim të sa më lart, mendojmë se shumica nuk u është përmbajtur me rigorozitet kritereve kushtetuese të vëna përmes jurisprudencës së Gjykatës ndër vite dhe që prezumohet se kanë gjetur pasqyrim edhe në kuadrin ligjor e nënligjor, duke ndërhyrë praktikisht në kompetencat e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në rastin konkret në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve të gjyqtarit relator, për shkak të ndryshimit të kritereve për prioritizimin e çështjeve për shqyrtim para këtyre gjykatave, të cilat mbajnë parasysh edhe gjendjen aktuale të ngarkesës së gjyqësorit.

15. Në përfundim, për të gjitha argumentet e përmendura më sipër, vlerësojmë se në rastin e kërkuesve Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Elsa Toska, Genti Ibrahimi, Ilir Toska